



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS  
MUNICIPALITY OF KLINA  
OPŠTINA KLINA



[www.komuna-klina.org](http://www.komuna-klina.org)

Zyra e Kryetarit të Komunës së Klinës

Nr. 060-30333/24

Klinë, datë: 05.09.2024

## PROCESVERBAL

**Nga dëgjim i shtatë publik buxhetor për buxhetin e vitit 2025 të Komunës së Klinës, me temën “Prioritetet e grave të komunës së Klinës, personat me aftësi të kufizuara dhe kategoritë e tjera të marginalizuara”, datë 21.08.2024, ora 13:00, vendi SHFMU “Ismet Rraci”, Klinë.**

Ky procesverbal është hartuar në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Ligjit për Financat Publike, Statutin e komunës së Klinës dhe duke ndjekur standardet e Udhëzimit Administrativ për Administratë të Hapur në komuna.

Ky procesverbal përmban një përmbledhje të redaktuar të procesit të zhvilluar gjatë dëgjimit buxhetor. Palët që kanë vërejtje në përmbajtjen e këtij procesverbali mund të dërgojnë kërkesë për ndryshim deri me datë 15/09/2024 në emalin [vlora.tafili@rks-gov.net](mailto:vlora.tafili@rks-gov.net) ose fizikisht në zyrën e pranimit në Komunën e Klinës.

Ky procesverbal është një dokument publik i cili hartohet sipas standardeve të Ligjit për Mbrojtjen e Privatësisë dhe Ligjit për Klasifikimin e Dokumenteve Zyrtare.

Ky dokument është publik në faqen e komunës në dy versione në PDF dhe Word dhe në arkivin e komunës i protokolluar sipas protokollit zyrtarë.

Hartuesi i këtij procesverbali ka redaktuar të dhënat personale të palëve të cilat janë mbledhur gjatë procesit. Vetëm palët e autorizuara mund të kenë qasje në të dhënat personale të mbledhura gjatë këtij procesi të cilat janë të arkivuara në komunë.

Ky dokument përmban të dhëna për fazën përgatitore të dëgjimit përmbledhjen na takimi dhe në aneks materialet e bashkangjitura të cilat janë grumbulluar gjatë takimit.

Para nisjes së diskutimit të pranishmit i janë nënshtruar procesit të regjistrimit në listën e pjesëmarrësve.

Në listën e pjesëmarrësve ata kanë ofruar emrin mbiemrin, numrin e telefonit dhe nënshkrimin e tyre. Të dhënat janë grumbulluar me qëllim të sigurimit të dëshmive për pjesëmarrjen e qytetarëve në dëgjimet buxhetore.

Të pranishmit janë pajisur me agjendën e takimit e cila u është dorëzuar në formë fizike dhe me materialet ku përfshihej prezantimi i draft buxhetit i cili është dorëzuar tek secili pjesëmarrës në formë fizike.

Para të pranishmëve është prezantuar draft buxheti edhe në formatin elektronik në tabelat e mençura.

Është konstatuar se për organizimin e këtij takimi nuk ka nevojë për përkthyes apo interpretim për personat me aftësi të kufizuara.

Takimi ka nisur në ora 13:00 të pranishëm ishin Nënkryetarja e Komunës së Klinës, znj. Marqe Tanushi – Selmanaj, drejtori i Urbanizimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Enver Berisha dhe anëtarë të grupit punues.

**Nga qytetarët morën pjesë 13 persona, prej të cilëve 12 gra dhe 1 burrë.**

*Shtojca 1 – Fotografi nga dëgjim i shtatë publik buxhetor për buxhetin e vitit 2025, me temën “Prioritetet e grave të komunës së Klinës, personat me aftësi të kufizuara dhe kategoritë e tjera të marginalizuara”, vendi SHFMU “Ismet Rraci”, Klinë.*



**Takimi u hap nga moderatorja, Vlora Tafili, e cili hapi dëgjimin buxhetor:**

“Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Faleminderit shumë për pjesëmarrje në këtë takim me rëndësi të veçantë ku do të diskutojmë për prioritetet e vitit 2025. Një përvojë të mirë të tillë e

kemi pasur edhe për buxhetin e vitit të kaluar, në një takim të tillë vetëm me gratë e komunës së Klinës dhe mendoj, e kam shprehur edhe publikisht në debate që disa nga idetë më të mira dhe më interesante të projekteve kanë ardhur nga gratë.

Duke u bazuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, Ligjin për Financa Publike dhe Udhëzimin Administrativ për Administratë të hapur në Komuna, sot ne po e mbajmë takimin e shtatë më radhë për draft buxhetin e komunës së Klinës për vitin 2025, një proces i rëndësishëm ky ku do të diskutojmë për t'i parë dhe njohë prioritetet e komunës për vitin e ardhshëm, sot specifikisht të grave të komunës së Klinës, personave me aftësi të kufizuara dhe kategoritë e tjera të marginalizuara

Sa i përketë prioriteteve, janë dy projekte që veç janë drejtë realizimit e që kanë ardhur nga gratë, siç e ceka edhe me lartë, nga takimi buxhetor i vitit të kaluar janë: Një shteg i ecjes, nga qytetarja Shqipe Ibishi, të cilit i është hartuar projekti për në Gryken e Jarines, si dhe mekanizma bujqësorë të ndryshëm të tjerë, jo sikur vitin e kaluar, nga qytetarja Suzana Temaj, andaj nga kategoria subvencione kemi pasur ndryshime sa i përketë furnizimit dhe ndarjes së mekanizmave bujqësorë.

Prandaj, bashkëbisedime të tilla do të kemi edhe sot bashkë me nënkryetaren e Komunës së Klinës, znj. Marqe Tanushi – Selmanaj, drejtori i Urbanizimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Enver Berisha dhe anëtarë të grupit punues. Po ashtu, me ne është edhe z. Kreshnik Gashi, konsulent nga DEMOS për të parë nga afër ecurinë e këtyre dëgjimeve. DEMOS-i, njëherësh na ka vlerësuar si komuna që ka pasur raportin më të mirë dhe më të detajuar në Republikën e Kosovës të cikleve të dëgjimeve buxhetore.

Para se t'ia kaloj fjalën nënkryetares dhe drejtorit të Urbanizimit, kisha kërku nga ju që më u nënshkrua në listën e pjesëmarrësve, sepse është një nga obligimet që dalin nga Udhëzimi Administrativ për Administratë të Hapur dhe është një dokument për ne, për të dëshmuar pjesëmarrjen e juaj. Gjithashtu, kushdo që merr fjalën të prezantohet për shkak të procesverbalit dhe të specifikojë kërkesën apo sugjerimin pasi bashke me grupin punues do ti trajtojmë kërkesat saktë dhe me arsyeshmeri në raportin e dëgjimeve dhe ta përcjellim atë për shqyrtim në seancën e rregullt të punës së Kuvendit Komunal, para së të miratohet buxhetiti.

Tani po ja kalojë fjalën nënkryetares së komunës.

Ju faleminderit edhe njëherë!”

**Të pranishmit u njoftuan nga moderatorja se për qëllime të dokumentimit të këtij takimi do hartohet procesverbali dhe komuna do publikoj video dhe fotografi nga ky takim.**

**Të gjithë të pranishmit dhanë pajtimin për regjistrimin e takimit dhe publikimin e imazheve nga ky takim.**

**Nënkryetarja e Komunës së Klinës, Marqe Tanushi - Selmanaj:** “Përshëndetje të nderuar të pranishëm, faleminderit shumë për prezencën në këtë takim, faleminderit mbi të gjitha për kohë që keni nda për ne duke i ditur angazhimet e gruas si në punë ashtu edhe familje. Kënaqësi

për mua të jem në mesin e juaj. Sot, jemi mbledhur për të diskutuar një nga përgjegjësitë më të rëndësishme që është buxheti i vitit 2025, i cili duhet të jetë pasqyrimi prioriteteve tona. Këto diskutime kërkojnë angazhimin tonë maksimal dhe të përbashkët, për të siguruar një buxhet të drejtë dhe të mirë balancuar.

Një nga aspektet kryesore që dua të theksoj është se ky buxhet duhet të pasqyrojë një angazhim të fortë për drejtësi sociale dhe përfshirje. Duhet të sigurojmë që asnjë qytetar, pavarësisht nga mosha, gjinia apo vendndodhja gjeografike, të mos mbetet pas. Për këtë arsye, mbështetja për grupet më të ndjeshme, si personat me nevoja të veçanta, të grave dhe vajzave dhe të rinjtë që kërkojnë mundësi dhe mirëqenie, do të jetë një pjesë thelbësore e diskutimeve tona.

Në këtë proces, roli ynë është të dëgjojmë zërin e qytetarëve, të marrim parasysh nevojat e të gjithëve. Transparenca dhe bashkëpunimi janë themeli i një procesi të suksesshëm të përgatitjes së buxhetit. Çdo shpenzim duhet të justifikohet, dhe çdo investim duhet të synojë një përmirësim të prekshëm të jetës së përditshme të njerëzve tanë.

Në emër të gjithë ekipit tonë, premtoj që do të jemi të hapur dhe të gatshëm të dëgjojmë propozimet dhe shqetësimet e secilit prej jush. Na takon ne që të bëjmë zgjedhjet e duhura, zgjedhje që do të ndikojnë në të ardhmen e këtij vendi dhe në mirëqenien e brezave të ardhshëm. Kryetari i komunës bashkë me ne dhe grupin punues ka përgatitur një agjendë prej dhjetë takimeve e kjo është një indikatorë që do të jemi sa më pranë gjithsecilit.

Faleminderit, dhe pres me padurim të kontribuoj në këtë proces të rëndësishëm për të mirën e përbashkët.”

*Shtojca 2 – Fotografi nga dëgjimi i pestë buxhetor gjatë moderimit:*



*Moderatorja, Vlora Tafili, më pas i dha fjalën drejtorit të Urbanizimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Enver Berishës.*

**Drejtori i Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Enver Berisha:** “Përshëndetje të nderuar të pranishëm, faleminderit shumë për prezencën në këtë takim.

Në mungesë të drejtorit të Financave do të bëjë para jush një prezantim apo përmbledhje të shkurtër të darft-buxhetit të vitit 2025, të cilin e keni para jush në kopje fizike po ashtu do e paraqesim edhe në tabelën digjitale.

Buxheti i Komunës së Klinës për vitin 2025 është gjithsej, i planifikuar në total prej 16,168,653.00, i cili krahasuar më vitin 2024 është afërsisht 2 milion euro më shumë, i cili ka qenë 14,648,717.00. Nga buxheti i vitit 2025, ajo shumë është e ndarë në këto burime; Granti i përgjithshëm me rreth 6,571,819.00; Granti specifik i arsimit me rreth 5,953,349.00; Granti i shëndetësisë me rreth 1,897,981.00, Të hyrat vetanake me rreth 1,495,504.00; Financimi për shërbimet rezidenciale me rreth 250,000.00, të cilat në japin në total pra 16,168,653.00.

Ndërsa, buxheti i komunës së Klinës sipas kategorive të shpenzimeve për periudhën 2025 – 2027, është i ndarë në të hyrat totale komunale me rreth 16,168,653.00, siç e thamë edhe më herët, të hyrat vetanake me rreth 1,495,504.00 edhe këtë e theksuam me lart po ashtu, Grantet dhe transferet qeveritare me rreth 14,673,149.00, Pagat dhe mëditjet me rreth 8,800,000.00, Subvencionet më rreth 800,000.00, si dhe ajo që po besojë që juve ju intereson më së shumti e që janë Investimet Kapital, kanë një buxhet prej 4,498,653.00. E për projektet kapitale do të bisedojmë bashkërisht. Siç e shihni në dokumentin fizik të buxhetit të cilin e keni përpara, ne si komunë e kemi hartuar një listë të prioriteteve për vitin 2025, po që të cilën mund të ndryshohet apo plotësohet deri ky buxhet të prezantohet në kuvend për tu miratuar.

Unë si drejtorë i urbanizmit do të ju njoftojë edhe me disa nga projektet më të rëndësishme që janë duke u ekzekutuar e që janë fundërruesi për furnizim me ujë të pijes, në vlerë afër një milion euro, rregullimi i shtratit të lumit “Klina”, me infrastrukturë përcjellëse për këmbësor dhe biçikletat, ka ndriçim modern dhe pushimore.

Ndërtimi shtegut nga qendra e qytetit, sheshi “Ndue Përllëshi”, deri tek udhëkryqi Pejë-Prishtinë, i cili shteg ka po ashtu infrastrukturë përcjellëse për këmbësor dhe biçikletat, ka ndriçim modern, pushimore dhe gjelbërim. Një projekt i tillë e kemi në fazën përfundimtare është po ashtu rregullimi i liqenit akumulues për ujin e pijes, ku ky liqen ka argjaturë të rregulluar në të dyja anët, ndërsa njëra anë ka infrastrukturë rekreative.

Unë nuk po zgjatem më shumë, jam këtu për çdo përgjigje, kërkesë, informacion apo ndonjë rekomandim që keni.

Ju falënderoj edhe njëherë!”

**Vlora Tafili:** “Faleminderit drejtor, pa humbur kohë po i kalojmë fjalën qytetarëve të pranishëm, por siç e theksova në fillim, për shkak të procesverbalit ju lutem kur të merrni fjalën të thoni emrin, mbiemrin edhe kërkesa juaj ta ketë adresën e specifikuar, mundësisht. Urdhëroni ?”

*Pas fjalës së moderatorës, fjala ju dha banorëve pjesëmarrës.*

**Shpresa Bekaj, banore e fshatit Krushevë e Madhe:** “Përshëndetje nënkryetare dhe ju drejtorë i Urbanizmit dhe ty Vlorë, faleminderit për organizimin e këtij takimi.

Kërkesa e parë që dua të them nuk ka të bëjë me buxhetin, mirëpo po e shprehi nevojën e madhe që kam për marrjen e pronave për shfrytëzim, sidomos pronën komunale. Unë bashkë me disa gra të fshatit Krushevë e Madhe merrmi me kultivimin e shumë produkteve bujqësore. Andaj, a mund të na orientoni pak se si shkon si procedurë shfrytëzimi pronës komunale për të cilën jemi shumë gra të interesuar mbjellim misër, grun etj.

Kërkesa e dytë sa i përketë buxhetit tek subvencionet e Bujqësisë apo kudo që mund të kategorizohet kjo jemi disa gra po ashtu që **kërkojmë ndërtimin e një hapësire për shitjen e produkteve tona bujqësore** të cilat i punojmë në shtëpitë tona po që nuk kemi ku ti shesim apo nuk jemi afër tregut ku mund të ketë edhe blerës. Ju faleminderit.

**Drejtori i Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Enver Berisha:** “Faleminderit Shpresa, kjo kërkesë shumë e arsyeshme sa i përketë punës suaj. Unë po e shënoje e po ashtu edhe Vlora në procesverbal, ne do ta shqyrtojmë dhe do të ofrojmë një opsion sa më të mirë të mundshëm.

Po ndalem pak të kërkesa juaj për shfrytëzim të pronës komunale. Drejtoria e Urbanizmit çdo vit i publikon në web faqen zyrtare të komunës së Klinës, listat e pronave për dhënie në shfrytëzim. Këto lista i kanë kodet e parcelës, hapësirën si dhe vendin. Ti mund të na drejtohesh me kërkesë për cilën do parcelë që të duket e nevojshme pastaj ne e përcjellim në kuvendin komunal dhe ata vendosin për dhënie në shfrytëzim.

**Vlora Tafili:** “Faleminderit drejtor, a do dikush tjetër fjalën. Po, urdhëroni?”

*Pas fjalës së drejtorit, fjala ju dha banorëve pjesëmarrës me radhë.*

**Vjollca Preka, banore e fshatit Stupë:** “Përshëndetje nënkryetare dhe ju drejtorë i Urbanizmit, faleminderit për organizimin e këtij takimi.

Unë jam Vjollca Preka, drejtoresh e shoqatës “HANDIKOS në Klinë”, e cila ka mbi 450 anëtar. Tash jemi edhe të licencuar si shoqatë. Shprehi këtu para jush kërkesën time për **ndërtimin e një objekti të cilin mund ta shfrytëzojnë apo sigurimin/lëshimin e një trualli/parcelë për ndërtimin e një objekti për shoqatën** për personat me nevoja të veçanta.

Ky objekt duhet të jetë përdhës në një hapësirë të madhe, një pjesë tjetër për depo, një pjesë për parking të automjetit të shoqatës, dhe pjesën e aktiviteteve në hapësirë ta hapur për personat me nevoja të veçanta

Kërkesën unë do ta përcjell edhe më shkrim, tek Vlora Tafili, ashtu siç thotë edhe njoftimi zyrtar, pasi kemi shumë nevojë që të na përkrahni në rrugëtimin tonë për plotësimin e kushteve dhe të drejtat e personave me aftësi të kufizuara të cilët janë mbi 450 anëtarë, ku çdo ditë shtohet numri me paraqitjen e rasteve të reja. Nëse, keni nevojë për dokumente si dëshmi do ju përcjellë edhe ato bashkë më kërkesën. Ju faleminderit shumë edhe njëherë.”

*Pas fjalës së drejtoreshës së “HENDIKOS”, fjala ju dha banorëve tjerë pjesëmarrës me radhë.*

**Nazife Gucati, banore në Klinë:** “Përshëndetje nënkryetare dhe ju gjithë të pranishëm,

Kërkesë për buxhetin e vitit 2025 që në komunën e Klinës të ndërtohet një objekt apo **strehimore për gratë që janë viktime të dhunës në familje**, apo objekt banesor në të cilin gratë viktime mund të qëndrojnë të sigurta pasi ato nuk kanë asnjë ndihmë financiare në momentin që e paraqesin rastin në polici dhe nuk jetojnë në shtëpinë e burrit. Të paktën pasi të kryhen procedurat ligjore fillestare të ju sigurohet një mbulesë e qerasë për banim. Ju faleminderit.”

**Nënkryetarja e Komunës së Klinës, Marqe Tanushi - Selmanaj:** “Po Nazife si institucione jemi të informuar mbi numrin dhe identitetin e viktimave në Klinë që kanë përjetuar dhunë në familje, ku sipas raportit të fundit nga stacioni i Policisë, janë 23 gra.

Ndërsa, për ndërtimin e strehimores për gratë që janë viktime të dhunës në familje në Klinë, komuna e Klinës për momentin është duke e përfunduar shtëpinë e kujdesit për të moshuar dhe njëherësh dhe nuk i ka kushtet financiare buxhetore të mjaftueshëm edhe për një objekt të tillë afër gjysmë milioni euro për një të ardhme të afërt siç është buxheti i vitit 2025.

Por, siç e dini komuna e Klinës ndan mbi 3.000 euro subvencione për strehimoren e grave që janë viktime të dhunës në familje, ka apo nuk ka viktime që qëndrojnë aty. Ky do të jetë njëherë për njëherë veprimet tona deri ne si institucione të krijojmë një zgjidhje të qëndrueshme.”

*Pas fjalës së nënkryetares, fjala ju dha banorëve pjesëmarrës me radhë.*

**Vitore Zefi, drejtoreshë e Qendrës Rinore “Ardhmëria”,** “Përshëndetje nënkryetare, juve drejtor i Urbanizmit dhe të gjithë pjesëmarrësve,

Si drejtoreshë e Qendrës Rinore “Ardhmëria”, e cila po ashtu është po ashtu Qendra e Aktivizimit në Komunitet, duke pas parasysh që si qendër një numër të madh të aktiviteteve me të rinjtë po edhe me gratë, kërkojë që në mënyrë që grat të përfshihen aktivisht, nga **subvencionet të ketë mjete apo fonde që t’ju mbulohet udhëtimi ose të sigurohet një automjet/autobusë i komunës për transport**

Po ashtu, nuk e di nëse planifikohet me këtë buxhet apo jo, do të ishte mirë të **rritet numri i punonjësve të mirëmbajtjes së hapësirave**, në veçanti atyre të gjelbërta pasi në qytet ekziston një nevojë e madhe për pastërti.”

**Vlora Tafili:** “Faleminderit Vitore, a do dikush tjetër fjalën. Po, urdhëroni?”

**Marije Gojani, banore e fshatit Krushevë e Madhe:** “Përshëndetje nënkryetare, Vlorë, drejtorë dhe ju të gjithë të pranishëm,

Siç e theksoi ma lart edhe Shpresa, në fshatin Krushevë e Madhe jemi një numër i madh i banorëve burra dhe gra që merremi me bujqësi. Kërkesa ime për buxhetin e vitit të ardhshëm është **ndërtimi kanalit të ujitjes në Krushevë të Madhe**, ju faleminderit.”

*Pas fjalës së znj. Marije, fjala ju dha banorëve pjesëmarrës me radhë.*

**File Palucaj, banore në Klinë:** “Përshëndetje nënkryetare, drejtorë dhe të gjithë juve,

Unë, jam File Plaucaj, përndryshe udhëhiqi një biznes të vogël i cili gjendet këtu në qytet. Merremi me qepjen e veshjeve kombëtare.

Do të doja të shtroja një kërkesë që nga ndarja e subvencioneve në bujqësi dhe për OJQ-të që ka komuna, kërkesë që të ndaj edhe **subvencione në formë të garantëve për biznese që të na ndihmojë me pajisje**. Ju faleminderit shumë.”

*Pas fjalës së znj. File, fjala ju dha banorëve pjesëmarrës me radhë.*

**Elbasane Morina, banore në fshatin Rigjevë:** “Përshëndetje nënkryetare dhe ju drejtorë i Urbanizmit, faleminderit për organizmin e këtij takimi.

Ashtu siç e cekim në fillim edhe nga mikja ime Nazife Gucati, kërkojë të ndërtohet një objekt apo **strehimore për gratë që janë viktime të dhunës në familje**, apo objekt banesor në të cilin gratë viktime mund të qëndrojnë të sigurt pasi ato nuk kanë asnjë ndihmë financiare. Unë edhe vetë jam viktimë e dhunës në familje, kam një vajzë të vogël dy vjeçare dhe jetojë me qira. Punojë dhe jetojë me një rrogë të vogël, ku mezi arrij ti mbulojë shpenzimet. Ju faleminderit shumë, shpresojë shumë që komuna të na bëjë një zgjidhje.”

**Vlora Tafili:** “Faleminderit znj. Morina,

A ka dikush tjetër që dëshiron të merr fjalën për ndonjë kërkesë apo rekomandim?”

Nëse jo, atëherë e shpalli të mbyllur takimin pas gjithë këtij diskutimi, ne si grup punues bashkë me kryetarin e komunës, nënkryetaren, anëtarët e grupit punues do të vazhdojmë në takimin e radhës në fshatin Gjurgjevik i Madh në ora 18:00 dhe takimet tjera të radhës sipas kësaj agjende;

Dëgjim publik me banorët e komunës së Klinës, me fokus banorët e fshatrave Gjurgjevik i Madh, Jashanicë, Dush i Vogël, Siqevë, Dobërdol dhe fshatrat e tjera, datë 21.08.2024, ora 18:00, vendi SHFMU “Tre Dëshmorët”, Jashanicë.

Dëgjim publik me banorët e komunës së Klinës, me fokus bujqit, fermerët, kultivuesit dhe afaristët që operojnë në Klinë, tema e diskutimit “Projektet investive në zhvillimin e bujqësisë dhe ekonomisë”, datë 22.08.2024, ora 17:00, vendi Salla e Kuvendit Komunal.

Dëgjim i përgjithshëm me banorët e komunës së Klinës, datë 25.08.2024, ora 17:00, vendi Salla e Kuvendit Komunal.



Për të gjitha këto takime ju kisha lut ta vizitoni web faqen zyrtare të komunës së Klinës po edhe rrjetin social Facebook për ma shumë detaje, apo edhe të më kontaktoni me email [vlora.tafili@rks-gov.net](mailto:vlora.tafili@rks-gov.net).

Koment, pyetje, sugjerimet e kërkesa e sotme që janë regjistruar në procesverbal, do të trajton në raportin final të dëgjimeve e më pas ky raport do të shqyrtohet në seancën e rregullt të kuvendit komunal para miratimit të buxhetit. Po që të cilin do ta gjeni të publikuar në web faqen zyrtare e aty mundeni me i pa secili prej juve që ka kontribuar përgjigjen edhe statusin e kërkesave.

Mirëmbetshi e faleminderit shumë për pjesëmarrjen sot”.

**Takimi u mbyll në ora 14:29.**

*Shtojcë – Tabela e pjesëmarrësve të ndarë sipas gjinisë.*

Gra	12
Burra	1
Totali	13

Procesmbajtësja,  
Vlora Tafili

